

TERMA REFERENCE

METODOLOGJI DHE SHKRIM RAPORTI PËR PYETËSOR ONLINE, ANKETAT DHE INTERVISTAT

Pozicioni / Shërbim	Ekspert për përgatitjen e metodologjisë dhe shkrimin e raportit për pyetësorët online, anketat dhe intervistat
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” 2024-2025
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi – ekspert për përgatitjen e metodologjisë dhe shkrimin e raportit për pyetësorët online, anketat dhe intervistat
Periodha e kontratës	Shtator 2024 – Shkurt 2025
Ditët e punës	20 ditë

Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” 2024-2025, Instituti i Studimeve Politike kërkon **ekspert për përgatitjen e metodologjisë dhe shkrimin e raportit analizues për pyetësorët online, anketat dhe intervistat.**

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Hartimi i planit të studimit dhe strategjive për realizimin e pyetësorëve on-line, anketave dhe intervistave;
- Krijimin e një database me të dhënat nga pyetësori;
- Grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre sipas kthim përgjigjeve të pyetësorit;
- Evidentimin e gjetjeve dhe zhvillimin e analizës mbi bazën e tyre;
- Hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala nga pyetësori;
- Ofrimin e angazhimit profesional në bashkëpunim me stafin e ISP për sugjerime, paqartësi, materiale shtesë, etj;
- Adresimin e gjetjeve, reflektimin e sugjerimeve të ISP, në variantin përfundimtar të dokumentit;
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Diplomë universitare për Shkenca Sociale, Politike, Filologjike apo Juridike;
- Të paktën dy vjet përvojë profesionale përkatëse në një funksion të ngjashëm- përgatitje metodologjie, analizimi të dhënash, punë kërkimore dhe nxjerrjen e rekomandimeve;
- Përvojë kërkimore (desk-research) dhe adresim rekomandimesh;
- Aftësi të shkëlqyera analizuese dhe hulumtuese;
- Shumë i/e organizuar në nivel detyre dhe projekti.

Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
3. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar;
2. Ofertë Financiare **e paraqitur në GBP, duke përfshirë TVSH;**
3. Punë të ngjashme të realizuara më parë nga kandidati.

Kostot dhe Pagesat

Kostoja dhe mënyra e pagesës përcaktohet pas lidhjes së Kontratës së Shërbimit dhe pas paraqitjes së raportit nga eksperti për punën e kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 23/09/2024 ora 23:59.

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com ose contactaips@isp.com.al
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*Ekspert për përgatitjen e metodologjisë dhe shkrimin e raportit për pyetësorët online, anketat dhe intervistat.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*Ekspert për përgatitjen e metodologjisë dhe shkrimin e raportit për pyetësorët online, anketat dhe intervistat.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike